

BLERINA GJYLAMETI



Datëlindja: 23.1.1980

Vendlindja: TIRANË

E-mail: Blerina.Gjylameti@parlament.al

Jetëshkrimi:

Është diplomuar në degën ekonomi, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Salernos, Itali. Ka një master shkencor në “Studime ekonomike europiane”, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe *Otto-Friedrich-Universität Bamberg*, si dhe është doktore shkencash në ekonomi dhënë nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Menaxhimit.

Ka punuar si pedagoge pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe pranë Universitetit Ushtarak “Skënderbej”. Nga viti 2013 është deputete e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore të organizuara nga Departamenti i Menaxhimit të Fakultetit Ekonomik të Tiranës, si dhe është bashkautore në disa publikime.

Ajo ka aftësi shumë të mira komunikimi përftuar nga eksperiencia si asistente pedagoge dhe lektore, si dhe është konfidente dhe e aftë të përcjellë idetë në publik, grupe apo përmes medias elektronike.